

VENDIM
Nr. 151, datë 3.7.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOMI TEC” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PLEPI”, ME FUQI TË
INSTALUAR
2285 kw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a” dhe të nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Domi TEC” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Domi TEC” sh.p.k., me shkresën nr. 29 prot., datë 25.4.2018, protokolluar në ERE me nr. 344 prot., datë 26.4.2018, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Plepi”, me fuqi të instaluar 2285 kw.

- ERE, me shkresën nr. 55/30 prot., datë 14.5.2018, ka bërë njoftimin në media për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit.

- ERE, me shkresën nr. 344/1 prot., datë 15.5.2018, i ka bërë me dije subjektit mungesën e dokumentacionit të kërkuar.

- ERE, me shkresën nr. 344/3 prot., datë 21.5.2018, ka njoftuar subjektin në lidhje me vendimarrjen e bordit.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 344/2 prot., datë 25.5.2018, subjekti ka përcjellë në ERE plotësimin e dokumentacionit të munguar, duke depozituar vërtetimet nga prokuroria dhe gjykata, si dhe studimin e fizibilitetit.

- ERE, në mbledhjen e datës 25.6.2018, pranoi kërkesën e shoqërisë “Domi TEC” sh.p.k. për shtyrjen e vendimarrjes.

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 344/5, datë 25.6.2018, ka përcjellë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujor nr. 272/1 prot., datë 20.6.2018, të miratuar me vendimin e Këshillit të Basenit Ujor, Drin–Bunë.

- Në përfundim të shqyrtimit, rezulton se aplikimi i shoqërisë “Domi TEC” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Domi TEC” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Plepi”, me fuqi të instaluar 2285 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti